



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës në pajtim me Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve (13 qershor 2017) dhe Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë (26 gusht 2021), hap:

**THIRRJE PUBLIKE PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR
FINANCIMIN E PROJEKTEVE/PROGRAMEVE PËR PERSONA FIZIK DHE OJQ**

Kjo thirrje publike bëhet më qëllim të mbështetjes financiare të projekteve apo programeve të propozuara nga personat fizik dhe OJQ-të, e të cilat janë të fokusuara në fushat si në vijim:

- Çështje gjinore dhe integrim socio-ekonomik;
- Rinia dhe inovacioni;
- Promovimi i shëndetit mendor;

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale, si në vijim:

- objektivat e projektit/programit të jenë të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme;
- aktivitetet e projektit/programit të jenë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- kostot e projektit/programit të jenë reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit.
-

Personat fizik dhe OJQ-të, mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje publike.

Të drejtë aplikimi me projektet/programet e tyre kanë personat fizik dhe OJQ-të, që dëshmojnë se projekti/programi i tyre është i fokusuar në njërin nga fushat e kësaj Thirrje Publike.

Në këtë thirrje publike nuk mund të aplikojnë përfituesit e mbështetjes financiare nga Zyra e Presidentes gjatë vitit 2024 si dhe ata që nuk kanë përmbyllur ende raportet e tyre për projekte që janë mbështetur më herët nga Zyra e Presidentes.

Personat fizik dhe OJQ-të obligohen që t'i kryejnë transaksionet financiare për realizimin e projektit për të cilin kanë përfutuar mbështetjen financiare nga Zyra e Presidentes në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të përmbushin detyrimet kontraktuale të krijuara deri në përfundim të programit/projektit të paraqitura edhe në kontratë.

Kërkesat dhe propozimet do të dorëzohen vetëm në formularin e aplikimit, i cili është në dispozicion në ueb-faqen e Presidencës: <https://president-ksgov.net/sq/shpallje>

- Dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike.
- Dokumentet e kompletuara nuk do të pranohen përmes postës elektronike.
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës
Sheshi Nëna Terezë, Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Zyra e Arkivit, Nr. N 319,
10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Aplikimi i personave fizik dhe OJQ-ve, do të konsiderohet i plotë nëse e ka të plotësuar të gjithë dokumentacionin përkatës siç kërkohet në thirrje publike, si në vijim:

- Formularin e plotësuar të aplikimit, ku përfshihet pjesa narrative dhe financiare e kërkesës;
- Kopjen e dokumentit të regjistrimit në organin kompetent, për OJQ-të;
- Kopjen e dokumentit të vlefshëm identifikues, në rast të aplikimit nga personi fizik;
- Kopjen e dokumentit identifikues të personit të autorizuar që përfaqëson OJQ-në;
- Certifikatën valide të numrit fiskal - (dëshmia e validitetit përmes vërtetimit tatimor);
- Vërtetimin e llogarisë bankare aktive jo më të vjetër se 6 muaj.

Shuma totale e alokuar për këtë thirrje publike është 100,000 (një qind mijë EURO).

Procesi i pranimit të aplikacioneve, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e subvencionit, koha dhe mënyra e paraqitjes së ankesave, si dhe monitorimi i realizimit të projekteve, do të bëhen sipas Rregullores MF - Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë.

Vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe që i përmbushin në tërësi kushtet e përcaktuara të thirrjes publike do të shqyrtohen për mbështetje financiare.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5,000.00 euro. Në raste të caktuara për projekte të interesit të veçantë, Komisioni vlerësues mund të trajtojë tejkalimin e shumës maksimale të parapara në këtë thirrje publike bazuar në kriteret specifike të propozim projekteve.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga dita e publikimit dhe përfundon më 27.08.2024.

Për çdo paqartësi lidhur me thirrjen publike mund të jepen sqarime vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: subvencione.zprk@president-ksgov.net, **deri më datën 19.08.2024.**